

ALEANCA GLOBALE E INSTITUCIONEVE KOMBËTARE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT (GANHRI)

Raporti dhe Rekomandimet e Sesionit Virtual të Nën-Komisionit për Akreditimin

(SCA)

7-18 Dhjetor 2020

... fq 15-16

2. Riakreditimi (Neni 15 i statutit të GANHRI-t)

2.1 Shqipëria: Institucioni i Avokatit të Popullit (AP)

Rekomandim: Nën-Komiteti i Akreditimit (SCA) rekomandon që Institucioni i Avokatit të Popullit duhet të riakreditohet me statusin A.

SCA vlerëson përpjekjet e AP për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut në Shqipëri. Ai inkurajon institucionin t'i vazhdojë këto përpjekje.

SCA thekson se Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (NHRI-të) që janë akredituar me status A duhet të ndërmarrin hapa të arsyeshëm për të rritur efektivitetin dhe pavarësinë e tyre, në përputhje me Parimet e Parisit dhe rekomandimet e bëra nga SCA gjatë këtij rishikimi.

SCA vëren:

1. Mandati

Mandati mbrojtës i AP nuk përfshin veprimet ose mosveprimet e subjekteve private. AP raporton se interpreton mandatin e saj në përfshirje të funksioneve publike të ushtruara nga njësi-të private dhe se pranon ankesa dhe harton rekomandime ndaj organeve përkatëse shtetërore në situata të tilla. Mandati i NHRI-së duhet të interpretohet në një mënyrë të gjerë, liberale dhe të qëllimshme për të promovuar një përkufizim progresiv të të drejtave të njeriut që përfshin të gjitha të drejtat e përcaktuara në instrumentet ndërkombëtare, rajonale dhe vendore. SCA thekson se mandati i një NHRI-je duhet të shtrihet në veprimet dhe mosveprimet e sektorit publik dhe privat.

Ndërsa pranon që PA e interpreton mandatin e saj gjerësisht siç u përmend më lart, SCA inkurajon AP që të avokojë për një mandat më të gjerë që përfshin aftësinë për të adresuar të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut që rezultojnë nga veprimet dhe mosveprimet e njësive private.

Në këtë drejtim, SCA thekson se, aty ku një NHRI është mandatuar me përgjegjësi shtesë, duhet t'i sigurohen burime shtesë për t'i mundësuar të marjen e përgjegjësi për të kryer këto funksione.

SCA u referohet Parimeve të Parisit A.1, A.2, A.3 dhe B.2 dhe Vëzhgimit të vetë të Përgjithshëm 1.2 mbi 'Mandatin e të drejtave të njeriut' dhe 1.10 mbi Financimin adekuat të NHRI-ve'.

2. Financim i duhur

SCA pranon që stafi dhe buxheti i AP janë rritur që nga viti 2014. Megjithatë, AP raporton se niveli i financimit është i pamjaftueshëm për të përmbushur nevojat për burime njerëzore, duke përfshirë mbajtjen e stafit me kohë të plotë në zyrat e saj rajonale.

SCA thekson që, për të funksionuar në mënyrë efektive, një NHRI duhet të pajiset me një nivel të duhur të financimit në mënyrë që të garantojë pavarësinë dhe aftësinë për të përcaktuar lirisht përparësitë dhe aktivitetet e veta. NHRI-ja gjithashtu duhet të ketë fuqinë për të alokuar fonde sipas përparësive të veta. Në veçanti, financimi i duhur duhet, në një shkallë të arsyeshme, të sigurojë realizimin gradual dhe progresiv të përmirësimit të operacioneve të NHRI-së dhe përmbushjen e mandatit, duke përfshirë pagat dhe përfitimet e stafit të saj të krahasueshme me ato të nëpunësve civilë që kryejnë detyra të ngjashme në institucione të tjera të pavarura të Shtetit.

SCA inkurajon AP që të vazhdojë të avokojë për fonde të përshtatshme, përfshirë sigurimin e stafit me kohë të plotë në zyrat e veta rajonale.

SCA i referohet Parimit B.2 të Parisit dhe Vëzhgimit të Përgjithshëm të vetë 1.10 mbi 'Financimin e duhur të NHRI-ve'.

3. Inkurajimi i ratifikimit ose aderimit në instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut

Ligji nuk e mandaton qartë AP-në të inkurajojë ratifikimin ose aderimin në instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. SCA pranon që AP interpreton gjerësisht mandatin e tij dhe bën rekomandime në lidhje me këtë, dhe e inkurajon AP që të vazhdojë në këtë drejtim.

SCA është e mendimit se inkurajimi i ratifikimit të, ose aderimit në, instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe zbatimi efektiv i atyre instrumenteve në të cilat Shteti është palë, janë funksionet kryesore të një NHRI-je. Parimet e Parisit përshkruajnë më tej që NHRI-të duhet të promovojnë dhe inkurajojnë harmonizimin e legjislacionit kombëtar, rregulloreve dhe praktikave me këto instrumente. Prandaj, SCA e konsideron të rëndësishme që këto detyra të jenë pjesë e legjislacionit të një NHRI-je.

SCA inkurajon AP-në që të vazhdojë interpretimin e mandatit të saj në një mënyrë të gjerë dhe të avokojë për ndryshimet e duhura në ligjin organik për t'i siguruar një mandat të qartë

për të inkurajuar ratifikimin ose aderimin në instrumentet rajonale dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

SCA i referohet Parimeve të Parisit A.3 (c) dhe Vëzhgimit të vetë të Përgjithshëm 1.3 mbi 'Inkurajimin e ratifikimit ose pranimit në instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut'.